

FJALA E DEPUTETES MILVA EKONOMI

E ENJTE 21 KORRIK 2022

Të nderuar kolegë deputetë,

Të nderuar qytetarë,

Në këtë seancë parlamentare vijmë pas një ngjarjeje të jashtëzakonshme në jetën administrative, në jetën politike dhe në jetën e integritetit të Shqipërisë, me hapjen e negociatave me Bashkimit Europian dhe për ne kjo përkon me ditën e dytë të punës. Të gjithë e dimë se për të bërë detyrat më mirë duhen mundësi të ndryshme pune, duhet të ndjekim standarde të tjera, duhen zbatuar disa parime dhe vlera, që e përafrojnë gjithnjë e më shumë Shqipërinë me familjen europine. Megjithatë, nuk do të vinim në këtë ditë nëse nuk do të kishim bërë disa detyra ose të mos kishim bërë disa punë.

Puna kryesore, që ne arritëm të marrim statusin e ri, ka qenë reforma në drejtësi, e cila e kaloi me sukses fazën e zbatimit dhe Shqipëria rankohet si një nga vendet më të avancuara në rajon për sa i përket reformës në drejtësi. Pra, ne kemi vendosur një sistem drejtësie, i cili është i besueshëm, i drejtë, i pavarur, profesional, transparent, i përgjegjshëm, efikas, që jep besim te publiku dhe për herë të parë, pas shumë vitesh edhe publiku beson se dënimi është ai i merituari. Pra, ata që kryejnë një krim marrin atë që meritojnë, në mënyrë individuale, të gjithë janë të barabartë përpara ligjit, pavarësisht se çfarë roli kanë ata në shoqëri. Po, po, ashtu është, individualisht ti je i përgjegjshëm përpara ligjit dhe merr dënimin që meriton.

Megjithatë, përvoja e reformave të mëdha të kryera nga vendi ynë, pa dyshim, që lë mënjanë se si kanë performuar institucionet e administratës publike. Për të thënë që ne kemi performuar mirë, ju renditët shumë raporte, unë do t'ju rendis dy raporte dhe do t'ju jap një përgjigje për raportet tuaja, që janë bashkim i progresraportit të Bashkimit Europian dhe raportit të OECD/SIGMA-ës, që shikon se si i përgjigjet Shqipëria ndaj administratës publike. Në këtë moment ajo që duhet të kemi parasysh, është se edhe ILDKPKI-ja ka bërë një punë shumë të madhe, e cila është vlerësuar në krye të herës nga BE-ja për mënyrën profesionale dhe

sistematike se si punon ky institucion, ka një nivel të lartë të kryerjes së detyrës, natyrisht, është i aftë t'u përshtatet edhe ndryshimeve që kërkohen.

Sot në raportprogres kemi tri shënime, që lidhen me performancën e inspektoratit, si dhe kemi një shënim që vjen, parimi numër 3 i SIGMA-s, lidhur me përgjegjshmërinë që kanë punonjësit civilë në administratën publike. Të gjitha këto na bëjnë të besojmë se në jetën e përditshme inspektorati ka punuar mirë, sepse e lidhim edhe me rezultatet. Çfarë ka ndodhur, në fakt, në punën e përditshme? Duke qenë se reforma në drejtësi ishte kryefjala, puna e përditshme e inspektoratit lidhej me të gjitha dosjet dhe verifikimin e pasurisë për të gjithë kandidatët e organeve të ndryshme të sistemit të drejtësisë, ku ka shqyrtuar plot 312 kandidatë dhe ka verifikuar 155 kërkesa. Megjithatë, duke bërë këtë detyrë, nuk harroi në asnjë moment se duhej të bënte edhe detyrat që ka në përshkrimin institucional.

Për këtë arsye ai ka bërë hetime të thelluara për 802 subjekte deklaruese, ka aplikuar 130 masa administrative me gjobë dhe ka referuar 16 raste penale pranë institucionit të prokurorisë, strukturave të hetimit tatimor dhe Policisë së Shtetit. Megjithatë, kur ne e diskutuam në Konferencën Kombëtare të Antikorrupsionit çështjen e korrupsionit, atë e pamë të vendosur në tri shtylla: në parandalim, në dënim dhe në ndërgjegjësim. Në kuadër të ndërgjegjëimit, që është një nga detyrat që ky institucion bën në mënyrë të vazhdueshme për të gjitha autoritetet përgjegjëse, kanë ndihmuar 282 autoritete përgjegjëse për të kryer më mirë plotësimin e procedurave. Në mbështetje të këtyre punëve që kanë bërë, kanë dhënë edhe disa masa administrative me gjobë për organizatat që i kanë gjetur në shkelje të detyrimeve ligjore.

Për më tepër, e kanë kuptuar, sepse si një institucion, i cili ka rolin e hetimit dhe të kontrollit, është shumë e rëndësishme që edhe punonjësit e administratës të trajnohen për mënyrën se si duhet të veprojnë. Gjatë vitit të kaluar 192 prej këtyre institucioneve kanë qenë prezente në këto trajnime dhe kanë marrë pjesë 220 njësi private që duhej të shikonin konfliktin e interesit, por kjo nuk është e vetmja. Shumë i rëndësishëm në këtë moment që flasim, është se deklarimin e pasurive të gjithë e bëjnë në mënyrë elektronike. Kjo u bë e mundur falë digjitalizimit, sepse ky institucion, nëpërmjet modeleve që krijoi, bëri të mundur komunikimin e

55 regjistrave të shtetit dhe marrjen e përgjigjeve në mënyrë imediate; edhe kur përgjigjja nuk ishte në mënyrë imediate, të vinte online nëpërmjet formës digjitale.

Nga ana tjetër, është shumë e rëndësishme që ky institucion në punën e tij të përditshme ka ndjekur politikën e transparencës, sepse të gjitha deklaratimet tona të pasurisë janë aty, janë për medien, janë për shoqërinë civile, janë për studiuesit e pavarur, të cilët duan të shikojnë deklaratimet e pasurisë. Janë pikërisht 3555 deklaratata pasurie që administrohen në faqen e komunikimit publik. Megjithatë, një detyrë tjetër që është marrë nga GRECO, sepse GRECO është ajo organizatë që shikon në mënyrë të vazhdueshme se si ne i plotësojmë detyrat e konfliktit të interesit dhe deklaratimit të pasurisë, lidhet edhe me Kodin Ministror. Për Kodin Etik Ministror qeveria e Shqipërisë rimori edhe një herë në shqyrtim faktin që ky kod vërtet ka qenë i botuar në shtator të viti 2013, por ka nevojë për t'u përditësuar me kushtet e reja të transparencës, gjithmonë e më shumë në rritje, që ne duam të bëjmë për punonjësit e administratës publike.

Së bashku me GRECO-n u vendos që brenda këtij viti të kemi disa manuale se si duhet të punojmë këtu në Kuvend, si duhet të sillemi këtu në Kuvend. Kur bëhet fjalë për një kod ministror dhe një kod etik të ligjvënësve, duhet të jetë në linjë me të gjitha rekomandimet që ka dhënë GRECO. Megjithatë, puna e kësaj organizate nuk mund të jetë e vetmja. Ajo duhet të punojë së bashku me Koordinatorin Kombëtar për Antikorrupsionin dhe me të gjithë rrjetin e koordinatorëve që ne kemi vendosur nëpër institucione, por duhet të lidhet ngushtë edhe me SPAK-un dhe duhet të sjellë vazhdimisht një përmirësim të hetimit administrativ dhe penal. E kemi këtë vëmendje ndaj korrupsionit, sepse është një nga kushtet e rëndësishme, që e shikojmë veten të angazhuar drejt BE-së.

Pa dyshim që për ne puna e këtij institucioni është shumë e rëndësishme. Unë dua të informoj edhe për disa gjëra që janë shumë të rëndësishme edhe për publikun lidhur me korrupsionin. Natyrisht, ka shumë organizata që matin nivelin e korrupsionit në botë. Megjithatë, ato që njihen, janë dy organizata të rëndësishme për ne: raporti që nxjerr Komisioni Europian nëpërmjet progresraportit, që e bën çdo vjeshtë të një viti të caktuar dhe shikon jo vetëm Shqipërinë, por të gjitha vendet e rajonit të Ballkanit, por ne konsiderojmë edhe raportin e

Transparency International. Raporti i Transparency International është një raport, i cili botohet mbi perceptimin dhe krijon një indeks, i cili merret edhe nga shumë organizata të tjera dhe përdoret për të dhënë shkallën e perceptimit. Në fakt, është për t'u theksuar se indeksi i perceptimit matet me dy nivele: me rankim dhe me pikëzim. Rankimi, pozicioni që ka Shqipëria, varet shumë nga lista e vendeve që marrin pjesë në këtë listim.

Lista e vendeve, që nga viti 2016 e deri në vitin 2021, ka lëvizur nga 168 vende në 181 vende, ndërsa pikëzimi i Shqipërisë në harkun kohor të 5 vjetëve ka qenë 35-36 score. Kjo tregon situatën që, edhe pse indeksi përdoret si një indeks pasqyrë dhe shumë organizata të tjera referojnë mbi këtë, ajo që vjen këtu është që për të gjitha rastet portalet shqiptare, që nuk janë pak, por janë 800, e marrin dhe e amplifikojnë një rast të caktuar, duke krijuar një pështjellim. Ndonjëherë, kur segmente të caktuara të shoqërisë duan të përkeqësojnë situatën, përdorin pikërisht këtë gjë, por publiku ka nevojë të informohet drejt, sepse fjala jonë e vetme është lufta kundër korrupsionit dhe lufta kundër korrupsionit bëhet vetëm në qoftë se institucionet e drejtësisë veprojnë sipas parimit të shtetit të së drejtës dhe për këto ne kemi reformën në drejtësi.

Reforma në drejtësi për ne ka qenë kryefjala jo vetëm për sjelljen e institucioneve, por edhe për të bërë luftën e vazhdueshme kundër korrupsionit dhe digjitalizimi, pa dyshim, që është një mjet efikas në luftën kundër korrupsionit. Nuk është i vetmi, sepse ai duhet të shoqërohet edhe me mjete të tjera, që kanë të bëjnë me një ndërgjegjësim më të madh të shoqërisë për të kuptuar se beteja kundër korrupsionit është beteja e çdonjërit prej nesh çdo ditë, në qoftë se duam një vend ku të respektohet prona, ku të respektohet fjala dhe ku të respektohet e drejta për të marrë vendime për një komunitet të vogël. Faleminderit!